



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA BERAT**  
**KRYETARI**

Nr. 5210/1 .Prot.

Berat, më 26/10/2020

**V E N D I M**  
Nr. 149 datë 26/10/2020  
**PËR**

**SHTESA NË PLANIN VJETOR TË PRANIMIT PËR VITIN 2020 ,NË  
INSTITUCIONIN E BASHKISË BERAT PJESË E SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, neni 8 ,pika 2, neni 9 ,gërma b, të nenit 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 108, datë 26.02.2014”Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, vendimit nr.120, datë 21.02.2020“Për miratimin e Strukturës, Organigramës së Administratës së Bashkisë dhe të Njësisë Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat”, për vitin 2020,i ndryshuar si edhe informacionin e Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për pozicionet e lira të krijuara në shërbimin civil në kategorinë e Ekzekutive dhe të Mesme Drejtuese ,Kryetari i Bashkisë ,

V E N D O S I:

1. Numri i vendeve vakante që i shtohen planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, në administratën e Bashkisë Berat, për vitin 2020, pjesë e shërbimit civil do të jetë **4(katër)** gjithsej sipas kategorive të mëposhtme :
  - a)Për kategorinë ekzekutive **3 (tre).**
    2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive janë si më poshtë :
      - Shkenca shoqërore
      - Shkenca ekonomike
      - Shkenca Inxhinierike
    3. Drejtoritë ku planifikohen vendet vakante janë :
      - Drejtoria e Taksave dhe Tarifave
      - Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
      - Drejtoria e Planifikimit Urban, lejeve dhe Monitorimit të Investimeve
    - b)Për kategorinë e Mesme Drejtuese **1 (një)**pozicion
      4. Drejtoria ku planifikohet të shtohet vendi vakant është :
        - Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik.
      5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse , në cilësinë e njësisë përgjegjëse.
      6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË  
Eryin Demo

